



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 388 Prot.

Tiranë, më datë 11.07.2025

VENDIM

Nr. 349, datë 11.07.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.07.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “*Salterra*” (zhvillimi i një kompleksi ndërtimesh të përbërë nga dy objekte me program hoteleri, shërbime dhe rezidencial + 13 dhe 24 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë), në zonën kadastrale 2832, Bashkia Vlorë, me zhvillues **subjekti “TURI M.Z.B.” sh.p.k.**;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “*Salterra*” (zhvillimi i një kompleksi ndërtimesh të përbërë nga dy objekte me program hoteleri, shërbime dhe rezidencial + 13 dhe 24 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë), si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijoje me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

